

**Republika e Kosovës****Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **31.05.2012**, pas shqyrtimit të Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

V E N D I M**Neni 1**

Ipët në diskutim publik Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale në territorin e Komunës së Vushtrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 01.06.2012 dhe zgjat deri më 20.06.2012.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që si hartues dhe propozues i Propozim-vendimit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu DBF-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Propozim-vendimit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Qershor 2012.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **31.05.2012**, pas shqyrtimit të Draft-rregullores për caktimin e kriterëve dhe mënyrën e ndarjes së shpërblimeve, mirënjohjeve, dekoratave dhe titujve të nderit, dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Është në diskutim publik Draft-rregullorja për caktimin e kriterëve dhe mënyrën e ndarjes së shpërblimeve, mirënjohjeve, dekoratave dhe titujve të nderit në territorin e Komunës së Vushtrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 01.06.2012 dhe zgjat deri më 20.06.2012.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerret masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që si hartues dhe propozues i Propozim-vendimit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu DKRS-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Qershor 2012.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa